



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Sh.II.nr.436/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Shtimës-Inspektori Sanitar, kundër debitorit të përmbartimit Operatori Ekonomik N.T.P “Beli Comerc” me seli në rrugën “Ukshin Kovaqica” Komuna e Mitrovicës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Civil, PPP.nr.663/20, të datës 02.02.2021, me datë 17.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e bazuar ankesa e kreditorit Komuna e Shtimës-Inspektori Sanitar, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Civil, PPP.nr.663/20, të datës 02.02.2021, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti Civil, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.663/20, të datës 02.02.2021, ka vendos si në vijim;

“Konsiderohet se është tërhequr propozimi i kreditorit Komuna e Shtimës-Inspektori Sanitare me adresë në rr.”Tiranës” Shtime, kundër debitorit Operatori Ekonomik N.T.P “Beli Comerc” me nr.të

biznesit 80130635 me adresë në rrugën “Ukshin Kovaqica” nr.224 Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av.Safet Voca nga Mitrovica.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale , me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar dhe çështjen ta kthej në rivendosje ose të ndryshohet aktvendimi i ankimuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale të Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Shtimës-Inspektori Sanitar, ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm aktvendimit të Udhëheqësi Për Sektorin Për Inspektorat-Inspektor Sanitar për pagesën e gjobës në lartës prej 500.00€ i cili është dokument përmbartues në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për Procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi privat ka aprovuar propozimin për përmbartimin e kreditorit dhe ka lejuar përmbartimin e propozuar në vlerë prej 500.00 Euro të lëshuar me urdhrin për përmbartim P.nr.126/2020 të datës 15.09.2020. Debitori ka ushtruar prapësim me datë 18.09.2020, duke kontestuar propozimin për përmbartim të kreditorit duke pretenduar se dokumenti përmbartimorë nuk ka qenë juridikisht i vlefshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim për faktin se në të njëjtin nuk janë shënuar me saktësi të dhënat e kërkuara ligjore për kreditorin dhe as adresa e sakt e tij, kështu ka cek se dokumenti përmbartimor nuk i ka tiparet e përmbartushmërisë konform dispozitave të nenit 36 par 1 dhe 2 të LPP-së, dhe se përmbartimi sipas këtij titulli ka qenë i pa lejuar, andaj ka propozuar që aprovohet prapësimi i debitorit dhe urdhëri për lejimin e përmbartimit të hudhet posht si e palejuar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si të pa bazuar.

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti Civil, me aktvendimin e ankimuar ka konsedriruar se është tërhequr propozimi i kreditorit, me arsyetim se me konkluzionine dt.30.12.2020 është ftuar kreditori Komuna e Shtimes Inspektori Sanitar që brenda afatit ligjor t'ia sjell gjykatës vendimin nr.08/98 të datës 15.05.2020 në origjinal ose kopje të vërtetuar sepas ligjit, po ashtu vulën e plotëfuqishmërisë dhe ekzekutshmërisë, gjithashtu sa i përket propozimit për përmbarrim gjegjësisht të bëhet përmirësimi sa i përket emrit të drejtorit të Operatorit Ekonomik N.T.P “Bleri Comerc”, ku në propozimin për përmbarrim shkruhet F.K. e në fakt duhet të jetë F.K., të njëjtën kreditori e ka pranuar me dt.12.01.2021 me paralajmërimin se nëse nuk veproni në përputhje me konkluzionin e lartëcekur procedura përmbarrimore në këtë çështje juridike do të konsiderohet e tërhequr, e nëse kthehet e pa plotësuar propozimi do të hudhet poshtë sipas nenit 17 dhe 38 të LPP-së dhe nenit 102 të LPK-së, krejt në fund ka cek se kreditori nuk ka vepruar brenda afatit të përcaktuar nga gjykata, andaj, duke u bazuar në nenin 102 par 3 të LPK-së propozimin e kreditorit e konsideroj të tërhequr.

Dhoma e Shkallës së Dytë para që ta shqyrtoj ankesën e kreditorit ka vrejtë së në shkresa të lëndës nuk gjindet fletëkthesa me të cilën do të vërtetohet se kur kreditori ka pranuar konkluzioni e datës 30.12.2020 në mënyrë që të vërtetohet se kreditori a ka vepruar në afatin kohorë me të cilën e ka përcaktuar gjykata, dhe për këtë kjo gjykatë e ka kthyer me aktpërcjellsë gjykatës së shkallës së parë që ta kompletoj lëndën me të gjitha shkresat e lëndës duke përfshirë fletëkthesën e lartcekur, gjykata e shkallës së parë me shkresën e datës 22.12.2023 ka dhënë përgjigje se pas shiqimit të rastit në zyrën e dorëzuesve kemi arritur ta gjejm dosjen se më datën 17.01.2021 është dërguar përmes shërbimit postar në adresën e kreditorit Komuna e Shtimës, mirëpo se si ka ardhur deri te mungesa e fletëkthesës së konkluzionit nuk mund të vi deri te konstatimi i sakt.

Më pas, Dhoma e Shkallës së Dytë ka shqyrtuar ankesën e kreditorit dhe me qenëse kreditori me ankesë ka bashkangjitur plotësim lidhur me konkluzioni e marrë nga gjykata e cila është protokuluar me datën 14.01.2023 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, kështu Dhoma e Shkallës së Dytë duke e vlerësuar aktvendimin e ankimuar, gjen se një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore, pasi që:

Dhoma e shkallës së dytë ka gjetur se aktvendimin e ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 1 dhe 182 par 2 pika i), për

arsye se palës nuk i është dhënë mundësia për shqyrtimin e çështjes në gjykatë. Në procedurën e zhvilluar pranë dhomës së shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së konkluzionit datës 30.12.2020, me të cilin ka ftuar kreditorin që të dërgoj gjykatës vendimin nr.08/98 të datës 15.05.2020 në original ose kopje të vërtetuar sipas ligjit si dhe vulën e plotëfuqishmërisë dhe ekzekutushmërisë, si dhe të bëhet përmirësimi sa i përket emrit të drejtorit të Operatorit Ekonomik N.T.P “Bleri Comerc”, ku në propozimin për përmbarim shkruhet F.K. e në fakt duhet të jetë F.K., andaj me që kreditori ka pranuar konkluzionin me datën 12.01.2021 ashtu si që është konstatuar në aktvendimin e ankimuar, dhe plotësimi i saj është bërë me datën 14.01.2021, e cila vërtetohet nga vula e pranimit në atë gjykatë, andaj kjo gjykatë ka vlerësuar se kreditori ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 102 par 3 të LPK-së. Andaj Dhoma e Shkallës së Parë është dashur verifikoj sakt dorëzimin e plotësimi të kreditorit nga kreditori ngase e nejtja është dorëzuar në gjykatë para marrjes së aktvendimit të ankimuar. Andaj, në këtë rast Dhoma e Shkallës së Parë, ka vepruar me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga 102 par 3 të LPK-së, ngase deri të shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore nga ana e dhomës së shkallës së parë ka ardhur pasi që dhoma e shkallës së parë nuk ka verifikuar sakt lidhur me dorëzimin e plotësimi të konkluzionit nga ana e kreditorit, dhe për këtë nuk ka pasur mundësi ligjore, që propozimin për përmbarim të kreditorit ta konsideron si të tërhequr.

Andaj, në ri procedurë, dhoma e shkallës së parë ti evitohet të metat e cekura, të vërtetohet faktet relevante, të zhvillojë procedurën përmbarimore në përputhje me dispozitat ligjore procedurale dhe pasi t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme, sipas vlerësimit të gjithanshëm të vendos drejt dhe sipas ligjit.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195, 208 dhe 209 par. 1 pika (d) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË**

K.Dh.Shk.II.nr.436/22 me datën 17.04.2024

Gj y q t a r j a,  
Franciska Zhitija-Ymeri